

**LIGJ**  
**Nr.7591, datë 16.7.1992**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7502, DATË 25.7.1991 "PËR PARTITË POLITIKE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi prej 30 deputetësh të Partisë Demokratike,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I :**

**Neni 1**

Në tekstin e nenit pesë shtohet fjalia:  
"Ndalohet organizimi dhe veprimtaria e partive e shoqatave politike në ndërmarrje prodhuese dhe institucione".

**Neni 2**

Neni 6 pika "b" ndryshohet si vijon:  
"Kur qëllimet e veprimtaria e saj kanë karakter antikombëtar, shovinist, racist, totalitarist, fashist, stalinist, enveristo-komunist dhe marksist-leninist".

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.251, datë 17.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**